Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit]**, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	



**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**  
\_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i materialit</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Vlera</b>
1	Tabelë rrugore (Vendkalim këmbësorësh) Nr.15	copë	10		
2	Tabelë rrugore (Ndalim qëndrimi) Nr.85	copë	7		
3	Tabelë rrugore (Ndalim qarkullimi) Nr. 54	copë	10		
4	Tabelë rrugore (Fëmijë) Nr. 25	copë	5		
5	Tabelë rrugore (Jep përparësi) Nr.40	copë	5		
6	Tabelë (60x40) parkim i rezervuar (per invalid)	copë	10		
7	Tuba per vendosje tabelash	copë	26		
8	Bojë e bardhë akrelike	kg	1500		
9	Bojë e bardhe bikomponente	kg	2100		
10	Mikrosfera qelqi	kg	260		
11	Bojë e verdhë akrilike	kg	200		
12	Shkrirës boje (diluent)	kg	750		
	<b>Shuma pa Tvsh</b>				
	<b>Tvsh 20 %</b>				
	<b>Shuma me Tvsh</b>				

---

### Shtojca 3

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

#### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

#### Shtojca 4

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

---

## Shtojca 5

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

### **1- BOJA: BIKOMPONENTE PLASTIKE E FTOHTE SPRAI 1:1 E BARDHE**

Boje bikomponente plastike ne te ftohte, per vijezim rruges, apilikim me makineri, ngjyra e bardhe.

Qellimi i perdorimit

- Boja do te perdoret mbi afalt, bitum, ne trotuare, ne rruge urbane dhe interurbane.
- Boja mund te hidhet mbi boje akrilike ose alkidike, dhe ne asfalt te ri.
- Boja duhet te kete kohw pwrdorimi 12 muaj nga data e furnizmit.

*Karakteristikat e bojes jane si me poshte:*

#### **Komponenti A**

- Koha e tharjes;  $\leq 30$  min, sipas standartit UNE135202.
- Ngjyrat; kordinatat e ngjyrave x,y sipas standartit UNE 135200 - 2 per ngjyren e bardhe
- Faktori reflektues;  $\beta \geq 0.80$ , sipas standartit UNE 48073-2
- Pershpejtimi i arritjes se ngjyrave ultraviolet;  $\beta \leq 0.005$  dhe xy brenda vlerave te vet ngjyres pa defekte dhe anomalji siperfaqesore, sipas standartit EN 1871.
- Rezistenca; bazike pa demtuar siperfaqen ( ne rast te aplikimit te drejtperdrejte ne beton), sipas standartit EN1871
- Dendesia relative;  $\pm 2\%$  e vleres se deklaruar (  $\rho = 2.00$  (1.96 -2.04) sipas standartit UNE135202/ EN ISO 2811-1.

- 
- Faktori reflektues;  $\pm 0.02$  e vleres se deklaruar  $\beta = 0.86$  (0.84 – 0.88), sipas standartit UNE 48073-2
  - Viskoziteti i krijuar - max .100 KU, sipas standartit UNE 48076.

## Komponenti B

- Koha e tharjes;  $\leq 30$  min, sipas standartit UNE135202.
- Ngjyrat; koordinatat e ngjyrave x,y sipas standartit UNE 135200 - 2 per ngjyren e bardhe
- Faktori reflektues;  $\beta \geq 0.80$ , sipas standartit UNE 48073-2
- Pershpejtimi i arritjes se ngjyrave ultraviolet;  $\beta \leq 0.005$  dhe xy brenda vlerave te vet ngjyres pa defekte dhe anomali siperfaqesore, sipas standartit EN 1871.
- Rezistenca; bazike pa demtuar siperfaqen ( ne rast te aplikimit te drejtperdrejte ne beton), sipas standartit EN1871
- Dendesia relative;  $\pm 2\%$  e vleres se deklaruar ( $\rho = 2.00$  (1.96 -2.04) sipas standartit UNE135202/ EN ISO 2811-1.
- Faktori reflektues;  $\pm 0.02$  e vleres se deklaruar  $\beta = 0.86$  (0.84 – 0.88), sipas standartit UNE 48073-2
- Viskoziteti i krijuar - max .100 KU, sipas standartit UNE 48076.
- Klasifikimi ne lidhje me flakerimin, irritimin dhe ndjeshmerine e lekures duhet te jete sipas Direktives Europiane CLP (EC) 1272/2008 ose analoge.
- Boja ne perputhje me Direktiven Europiane (EC) 1907/2006 duhet te permbaje:
  - Metil Metakrilat , ne perqendrim 10 -  $< 25\%$
  - Butyl Akrylate , ne perqendrim 2.5 -  $< 10\%$
  - Acid Metrakrilik, monoester me propan1.2 – Diol, ne perqendrim 2.5 -  $< 10\%$
  - Metiletil Acetate ne perqendrim  $< 1\%$
- Kushtet e magazinimit, maksimumi i temperatures  $35^{\circ}\text{C}$ , ndersa minimumi i temperatures  $5^{\circ}\text{C}$
- Boja ne paraqitje duhet te kete keto karakteristika:
  - Gjendja fizike ne  $20^{\circ}\text{C}$ , te jete e lengeshme
  - Pamja e jashteme/Praqitja, te jete viskoze
  - Ngjyra , te jete e bardhe
- Boja ne luhatsmeri duhet te kete keto karakteristika;
  - Pika e valimit ne presin atmosferik,  $121^{\circ}\text{C}$
  - Presioni i avullit ne  $20^{\circ}\text{C}$ , 2458 PA
- Densiteti ne  $20^{\circ}\text{C}$ ,  $2000 \text{ Kg/m}^3$
- Densiteti dinamik ne  $20^{\circ}\text{C}$ , 1820 cP
- Densiteti kinematik ne  $40^{\circ}\text{C}$ ,  $>20.5 \text{ cSt}$

Standartet qe duhet te plotesoje boja bikomponente plastike ne te ftohte, per vijezim rrugesh:

- Standartin UNE 135202 lidhur me dendesine relative.
- Standartin UNE 135202-2 2002 lidhur me ngjyren, koordinatat e ngjyrave.
- Standartin UNE 48073-2 lidhur me faktorin reflektues.
- Standartin EN 1871 lidhur me pershpejtimin e arritjes se ngjyrave ultraviolet.
- Standartin UNE 48076 lidhur me viskozitetin e krijuar.
- Standartin EN 1436: 2009+A1, lidhur me kerkesat e shenimit rrugor, perkatesisht:

- Pamja /Dukshmeria gjate nates me shi, koeficienti i vetereflektimit te drites  $R_L$ , i Klasit (R)
- Pamja /Dukshmeria gjate nates se thate, koeficienti i vetereflektimit te drites  $R_L$ , i Klasit (RR)
- Pamja /Dukshmeria gjate nates se lagesht, koeficienti i vetereflektimit te drites  $R_L$ , i Klasit (RW)
- Pamja /Dukshmeria gjate dites, koeficienti i perhapjes se ndricimit  $Q_d$ , i Klasit (Q)
- Pamja /Dukshmeria gjate dites, faktori i ndricimit  $\beta$ , i Klasit (B)
- Pamja /Dukshmeria gjate dites, koordinatat Kromatrike (x,y), i Klasit (Kalueshem)
- Rezistenca ne rreshkitje, njesia SRT, i Klasit (S)
- Lloji i sistemit te shenuar rrugor, Lloji I/II

Standartin EN 13197:2009, lidhur me qendrueshmerine, perkatesisht:

- Pamja /Dukshmeria gjate nates me shi, koeficienti i vetereflektimit te drites  $R_L$ , i Klasit (R5)
- Pamja /Dukshmeria gjate nates se thate, koeficienti i vetereflektimit te drites  $R_L$ , i Klasit (RR2)
- Pamja /Dukshmeria gjate nates se lagesht, koeficienti i vetereflektimit te drites  $R_L$ , i Klasit (RW5)
- Pamja /Dukshmeria gjate dites, koeficienti i perhapjes se ndricimit  $Q_d$ , i Klasit (Q5)
- Pamja /Dukshmeria gjate dites, faktori i ndricimit  $\beta$ , i Klasit (B5)
- Pamja /Dukshmeria gjate dites, koordinatat Kromatrike (x,y), i Klasit (Kalueshem)
- Rezistenca ne rreshkitje, njesia SRT, i Klasit (S1)
- Lloji i sistemit te shenuar rrugor, Lloji /II

## **2- MIKROSFERA TE QELOETA**

**Qe vijezimi te jete reflektiv duhen mikrosfera te qelqta mbas aplikimit te bojës bikomponente.**

Mikrosferat e qelqta duhet te jene ne perputhje me standartet Europiane EN 1423/ A1 dhe te kombinohen ne vijezimin me boje bikomponente, per ndertimin e shenjave rrugore ne perputhje me kerkesat standarte te Bashkimit Europian EN 1436.

Mikrosferat e qelqta duhet kene ngjitje te vecante me bojën bikomponente plastike ftohtë dhe permasat e e perhapjes te jene rreth 125 dhe 1.180 mikron.

### **Sasia e shperndarjes**

Madhesia e sites / sasia e shperndarjes

1400  $\mu$  / 0 – 2 % ; 1180  $\mu$  / 0 – 10% ; 1000  $\mu$  / 0 - 20 % ; 850  $\mu$  / 10 - 30 % ; 600  $\mu$  / 20 - 60% ; 355  $\mu$  /50 – 90% ; 212  $\mu$  /70- 100% ; 125  $\mu$  /95-100%

Forma e mikrosferave : grimca 1000  $\mu$

Perqindja e demtimeve apo rruazave te gabuara ;  $\leq$  20%.

Qendrueshmeria ne uje (H<sub>2</sub>O); pa ndryshime te siperfaqes ; Qendrueshmeria ne acid ( HCL); pa ndryshime te siperfaqes ; Qendrueshmeria ne kripe (Ca Cl<sub>2</sub>) ; pa ndryshime te siperfaqes ; Qendrueshmeria ne sulfat ( Na<sub>2</sub>S); pa ndryshime te siperfaqes

*Standartet qe duhet te plotesojne mikrosferat e qelqta:*

---

Standartin EN 1436: 2009+A1, lidhur me kerkesat e shenimit rrugor, perkatesisht:

- Pamja /Dukshmeria gjate nates me shi, koeficienti i vetereflektimit te drites  $R_L$ , i Klasit (R)
- Pamja /Dukshmeria gjate nates se thate, koeficienti i vetereflektimit te drites  $R_L$ , i Klasit (RR)
- Pamja /Dukshmeria gjate nates se lagesht, koeficienti i vetereflektimit te drites  $R_L$ , i Klasit (RW)
- Pamja /Dukshmeria gjate dites, koeficienti i perhapjes se ndricimit  $Q_d$ , i Klasit (Q)
- Pamja /Dukshmeria gjate dites, faktori i ndricimit  $\beta$ , i Klasit (B)
- Pamja /Dukshmeria gjate dites, koordinatat Kromatrike (x,y), i Klasit (Kalueshem)
- Rezistenca ne rreshkitje, njesia SRT, i Klasit (S)
- Lloji i sistemit te shenuar rrugor, Lloji I/II

Standartin EN 13197:2009, lidhur me qendrueshmerine, perkatesisht:

- Pamja /Dukshmeria gjate nates me shi, koeficienti i vetereflektimit te drites  $R_L$ , i Klasit (R5)
- Pamja /Dukshmeria gjate nates se thate, koeficienti i vetereflektimit te drites  $R_L$ , i Klasit (RR2)
- Pamja /Dukshmeria gjate nates se lagesht, koeficienti i vetereflektimit te drites  $R_L$ , i Klasit (RW5)
- Pamja /Dukshmeria gjate dites, koeficienti i perhapjes se ndricimit  $Q_d$ , i Klasit (Q5)
- Pamja /Dukshmeria gjate dites, faktori i ndricimit  $\beta$ , i Klasit (B5)
- Pamja /Dukshmeria gjate dites, koordinatat Kromatrike (x,y), i Klasit (Kalueshem)
- Rezistenca ne rreshkitje, njesia SRT, i Klasit (S1)
- Lloji i sistemit te shenuar rrugor, Lloji /II

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE TË SINJALEVE RRUGORE VERTIKALE**

Te gjitha tabelat duhet te jene konform "Manual i Drejtuesit te mjetit" botim Tirane 2020

### **Karakteristikat teknike e cilësore të sinjaleve vertikale.**

Furnizuesit e sinjaleve rrugore (tabelave dhe mbajtesve te tyre ) duhet te plotesojne kerkesat e meposhtme:

- Te gjithe sinjalet duhet te jene rigorozisht ne perputhje me Kodin Rrugor te Republikes se Shqiperise aprovuar nga Kuvendi Popullor me ligj nr. 8378, date 22.07.1998 dhe Rregulloren e zbatimit te Kodit Rrugor me V.K.M.Nr.153, date 07.04.2000. Perputhja konsiston ne tipin, formen, dimensionin, permasat, ngjyrat etj.
- Te gjitha shenjat rrugore te jene ne cdo pjese te tyre me llamarine hekuri te spesorit 1 mm.

Cdo sinjal duhet te jete i perforcuar ne te gjithe perimetrin e tij ne nje bordure te kthyerne kend. Te gjitha sinjalet ne pjesen e pasme duhet te permbajne elemente konstruktive, te cilet te bejne te mundur mberthimin e saj ne bishtin e tabelës. Shenjat me siperfaqe me te madhe se 0.8 m<sup>2</sup>, disqet dhe 8- kendeshat me diameter 90 cm, shenjat drejtuese etj, duhet te kene elemente

---

perforcues ne pjesen e pasme te tyre per gjithë gjatesine. Pjesa perforcuese duhet te jete e pershtatshme per rreshqitje dhe mberthim ne te tere gjatesine e stafave montuese ne mbajtese te shenjës.

- Per evitim e vrimave ne tabele te gjitha shenjat duhet te pajisen ne pjesen e pasme me profile perforcues  
ω te pershtatshme per t'u mberthyer ne anen e stafave, ne tubat mbajtes me diameter 60 mm.
- Lidhjet me saldime dhe gjithë lidhjet e tjera ndermjet tabelës dhe elementeve te tjere struktural duhet te jene bere ne menyre te tille, t'i rezistojne korrozionit gjate gjithë periudhes se jetegjatesise se tabelës.
- Perforcimet:

Çdo element duhet te kete ne pjesen e pasme profil ω formuar nga nje kanal ne te gjithë gjatesine, qe ka nje funksion te dyfishte: perforcimin e tabelës qe jep mundesi per fiksim te lehte dhe pozicionim korrekt te tabelës ne bishtin e saj.

#### **Kompozimi ( përbërja) e faqes së përparme të tabelës.**

- Siperfaqja e perparme e tabelës, mbasi eshte lyster me boje, mbi te aplikohet celuloidi reflektues sipas klasit te kerkuar (klasi I dhe klasi II) sipas cdo tipi te sinjalit.
- Perberesi reflektues duhet te kete karakteristikat fotometrike, kolometrike e teknologjike sipas kerkesave bashkangjitur ne perputhje me kerkesat e RREGULLORES SE ZBATIMIT TE KODIT RRUGOR.

#### **Pjesa e prapme e tabelës.**

- Ne pjesen e prapme te tabelës, ashtu sic eshte parashikuar ne nenin 37 te V.K.M. nr.153, date 7/4/2000, neni 75 paragrafi 7, duhet te shenohet enti pronar i rruges, marka e firmes qe ka prodhuar sinjalin, viti i prodhimit si dhe numuri i lejes qe eshte i dhene kesaj firme nga Ministria e Transportit per prodhimin e sinjaleve rrugore. Te gjithë shenimet e mesiperme duhet te jene te permbledhura ne nje siperfaqe prej 20 cm<sup>2</sup>.

#### **Karakteristikat dhe cilësia e mbajtësve të shenjave rrugore.**

- Mbajteset me tuba te shenjave vertikale duhet te jene tuba celiku me diameter 60 mm dhe me trashesi 3 mm, te xinguara ne te nxehte sipas normave ASTM 123 dhe te palyera me ndonje lloj boje.
- Tubi ne pjesen e siperme duhet te jete i mbyllur me nje tape plastike kurse ne pjesen e poshtme te kete vrima per kalimin ne to te shufrave prej hekuri, per te evituar rrotullimin e tubit ne bazament.
- Stafat mberthyes te shenjës dhe bulona, dado, rrota, duhet te jene te xinguara ne te nxehte.

#### **Garancia e materialeve.**

- Firma zbatuese duhet te garantoje materialet e furnizuara nga pikepamja e cilesise dhe e konstruksionit per te gjithë periudhen e perdorimit te tyre.
- Materialet e reflektueshme te perdorura ne shenjat rrugore, duhet te jene ne perputhje me kerkesat e



---

V.K.M.nr.153, date 7/4/2000 dhe te plotesojne edhe kushtet e meposhme:

- Sinjalet me celuloid te klasit te I duhet te kene vlerat fotometrike jo me pak se 50% te vleres se meparshme  
( burimit te drites) mbas nje periudhe prej 7 vjetesh.
- Sinjalet me celuloid te klasit te II duhet te kene vlerat fotometrike jo me pak se 80% te vleres se meparshme (burimit te drites) mbas nje periudhe sherbimi prej 10 vjetesh.
- Kordinatat kolorimetrike duhet te jene te perfshira ne zonen e specifikuar, per cdo ngjyre gjate gjithë periudhes se jetegjatesise se shenjës, per te gjithë materialet reflektues te perdorur.
- Te gjithë materialet reflektues te perdorur duhet te mos demtohen gjate gjithë periudhes se jetegjatesise per nga shkeputja nga siperfaqja e tabelës, grisja dhe demtimi, ose demtime te tjera qe mund te ndryshojne informacionin e pershkruar ne sinjal.
- Te gjitha lidhjet si saldime, lidhjet me bulona e stafe etj. duhet te garantojne qendruesmerine dhe te mos korrodohen gjate gjithë periudhes se perdorimit.

### Boje e bardhe akrilike

Boje qe perdoret per sinjalsitiken horizontale me ngjyre te bardhe e perbere nga resine akrilike me plastifikim te paster, pigmenti, mbushes, microsfera xhami, tretes dhe elemnete te tjere shtese qe i referohen lysterjes me nje rezistence te shkelqyer ndaj agjenteve atmosferik dhe abrasionit dhe me nje tregues te reflektimit RL (me te vogel se 100 mcd/mq).

Realizimi sipas nje tharje te rregullt lejon arrijten e nje aderimi te mire ne siperfaqen e rruges. Per te marre fillimisht nje vlere te larte te reflektimit RL ( me te madh se 100 mcd/mq ) eshte e nevojshme post-sprucimi me pas i produktit me mikrosfera xhami ne sasine jo me te vogel se 300 gr/mq, ndaj nje sasie produkti jo me te vogel se 800 gr/mq.

Tipi i bashkuesit: Resin Akrilike

Perberesit Avullues me 105°C sipas PF 13)	75 – 85	%
Tretesi	25 – 15	%
Permbajtja e hirit ne 900°C (sipas PF 14)	51 ± 3	%
Masa volumetrike (sipas UNI 8360 )	1.70 – 1.80	( kg./l.)
Viskoziteti ne 23 ± 2°C ( sipas UNI 8361 )	85 – 100	( ku )
Bioksid i Titanit	12	%
Permbajtja e Pigmentit	53 ± 1	%
<del>Knaethajespr 30</del> <del>inteligshise</del> (sipas PF 01)		
<input type="checkbox"/> Pluhuri i jashtem	5	(minuti)
<input type="checkbox"/> E zbatuar	30 – 35	(minuti)
Mikrosfera xhami	15.6	%

Menyra e perdorimit: Aplikim me sprucim ( me pipe me diameter 4 mm, presion 3,5 atm ) me hollimin me pak te mundshem dhe ne sasi te mjaftueshme derisa produkti te dali mire nga pipa

---

e pistoletes, ku gjithesesi shtohet nje limit prej 4% e peshes se dylyentit. Rakomandohet te aplikohet produkti ne siperfaqe teresisht te thara, pa pluhur dhe vajra, me nje temperature te ajrit jo me pak se 10°C dhe te nje lageshtie atmosferike jo me te madhe se 70%.

**RUAJTJA:** Mbajeni produktin te mbyllur mire ne paketimin e tij origjnal, larg te nxehtit, diellit dhe ngricave. Ne kushte te tilla produkti paraqet nje stabilitet prej gjashte muajsh .

### **Boje e verdhe akrilike**

Boje qe perdoret per sinjalsitiken horizontale me ngjyre te verdhe e perbere nga resine akrilike me plastifikim te paster, pigmenti, mbushes, microsfera xhami, tretes dhe elemnete te tjere shtese qe i referohen lyerjes me nje rezistence te shkelqyer ndaj agjenteve atmosferik dhe abrasionit dhe me nje tregues te reflektimit RL (me te vogel se 100 mcd/mq).

Realizimi sipas nje tharje te rregullt lejon arritjen e nje aderimi te mire ne siperfaqen e rruges. Per te marre fillimisht nje vlere te larte te reflektimit RL ( me te madh se 100 mcd/mq ) eshte e nevojshme post-sprucimi me pas i produktit me mikrosfera xhami ne sasine jo me te vogel se 300 gr/mq, ndaj nje sasie produkti jo me te vogel se 800 gr/mq.

Tipi i bashkuesit: Resin Akrilike

Perberesit Avullues me 105°C ( sipas PF 13 )	75 – 85	%
Tretesi	25 – 15	%
Permbajtja e hirit ne 900°C ( sipas PF 14 )	51 ± 3	%
Masa volumetrike ( sipas UNI 8360 )	1.70 – 1.80	( kg./l. )
Viskoziteti ne 23 ± 2°C ( sipas UNI 8361 )	85 – 100	( ku )
Bioksid i Titanit	12	%
Permbajtja e Pigmentit	53 ± 1	%
<b>Koha e tharjes per 30 m te lageshtise (sipas F01)</b>		
<input type="checkbox"/> Pluhuri i jashtem	5	( minuti )
<input type="checkbox"/> E zbatuar	30 – 35	( minuti )
Mikrosfera xhami	15.6	%

Menyra e perdorimit: Aplikim me sprucim ( me pipe me diameter 4 mm, presion 3,5 atm ) me hollimin me pak te mundshem dhe ne sasi te mjaftueshme derisa produkti te dali mire nga pipa e pistoletes, ku gjithesesi shtohet nje limit prej 4% e peshes se dylyentit. Rakomandohet te aplikohet produkti ne siperfaqe teresisht te thara, pa pluhur dhe vajra, me nje temperature te ajrit jo me pak se 10°C dhe te nje lageshtie atmosferike jo me te madhe se 70%.

**RUAJTJA:** Mbajeni produktin te mbyllur mire ne paketimin e tij origjnal, larg te nxehtit, diellit dhe ngricave. Ne kushte te tilla produkti paraqet nje stabilitet prej gjashte muajsh .

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Nr.	Emërtimi i materialit	Njësia	Sasia
1	Tabelë rrugore (Vendkalim këmbësorësh) Nr.15	copë	10
2	Tabelë rrugore (Ndalim qëndrimi) Nr.85	copë	7
3	Tabelë rrugore (Ndalim qarkullimi) Nr. 54	copë	10
4	Tabelë rrugore (Fëmijë) Nr. 25	copë	5
5	Tabelë rrugore (Jep përparësi) Nr.40	copë	5
6	Tabelë (60x40) parkim i rezervuar (per invalid)	copë	10
7	Tuba per vendosje tabelash	copë	26
8	Bojë e bardhë akrelike	kg	1500
9	Bojë e bardhe bikomponente	kg	2100
10	Mikrosfera qelqi	kg	260
11	Bojë e verdhë akrilike	kg	200
12	Shkrirës boje (diluvent)	kg	750

**Afatet e lëvrimit: 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.**

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]  
**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

*1. Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimi/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).*

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2019, 2020 dhe 2021) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit/loteve e përkatësisht **1,074,808** (një milion e shtatëdhjetë e katërmijë e tetëqind e tetë) lekë.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare*

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2019, 2020 dhe 2021 ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2021 (Sipas QKB) sipas percaktimeve në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

- 
1. Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit prej 537,403 (pesëqind e tridhjetë e shtatëmije e katërqind e tre) lekë, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
    - a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës
    - b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
  2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015** ose i përditësuar, mbi "Sistemin e menaxhimit të cilësisë", (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).  
(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallrave, shërbimeve apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).
  3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit ku të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.
  4. Autorizimin e kompanisë prodhuese/distributorit për shitje. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/ve si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
  5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit do ta shoqërojë atë (paraqesë) me Certifikatën e cilësisë dhe me Certifikatën e origjinës së mallit.
  6. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë origjinale se mallrat e ofruar janë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare përkatëse të dhëna në specifikimet teknike të mallrave.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I, Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I:

#### Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]



<p>kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-.</p>	<p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të</p>	<p>_____</p>

Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	<b>Po</b> [ ]
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	<b>Po</b> [ ]
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	<b>Po</b> [ ]
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	<b>Po</b> [ ]
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	<b>Po</b> [ ]
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	<b>Po</b> [ ] <b>Jo</b> [ ]
